

# GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

## SEKSIONI I TRETË

### ÇËSHTJA SUPERGRAV ALBANIA SHPK KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 20702/18)

#### VENDIM

Neni 6 § 1 (civil) – Privimi nga e drejta për t’iu drejtar gjiqatës për shkak të rrëzimit të ankesës kushtetuese si një ankesë e depozituar përtej afatit katërmujor, të përllogaritur duke nisur nga data e miratimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe jo nga data e shpalljes së vendimit të arsyetur plotësisht.

STRASBURG  
9 maj 2023

#### I FORMËS SË PRERË 9 gusht 2023

*Ky vendim është bërë i formës së prerë ne mbështetje të nenit 44 §§ 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.*

Në çështjen Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë,  
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Sekcioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë, e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar*,

Georgios A. Serghides,

Jolien Schukking,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Milan Blaško, *sekretar i Sekcionit*,

Duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 20702/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një kompani shqiptare, Supergrav Albania sh.p.k. (“kompania kërkuese”), më 23 prill 2018;

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për ankesën në lidhje me të drejtën e kompanisë kërkuese për t’iu drejtuat Gjykatës Kushtetuese dhe për të deklaruar pjesën tjeter të kërkësës së papranueshme;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 11 prill 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Çështja konkrete ka të bëjë me të drejtën e kompanisë kërkuese për t’iu drejtar Gjykatës kushtetuese, e cila e deklaroi ankesën e saj kushtetuese të papranueshme pasi ishte depozituar jashtë

afatit. Problematika kryesore në çështjen konkrete është nëse afati katërmujor për depozitimin e një ankesë kushtetuese do të duhej të llogaritej nga data kur ishte dorëzuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese për kompaninë kërkuese apo nga data e shpalljes së këtij vendimi.

#### FAKTET

2. Kompania kërkuese u regjistrua në vitin 2006, në Burrel. Ajo u përfaqësua nga D. Prifti, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj periudhe, Z. A. Metani, dhe në vijim nga Z. O. Moçka, nga Avokatura e Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përbldhen si më poshtë.

5. Kompania kërkuese paraqiti një padi civile pranë Gjykatës së Rrethit Mat kundër policisë rajonale Mat, ku kërkonte shpërblim në lidhje me çmontimin e makinerisë së saj. Më 13 Korrik 2012, gjykata e shkallës së parë e rrëzoi padinë, dhe ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Rrethit Tiranë më 11 Prill 2013.

6. Më pas, kompania kërkuese apeloi pranë Gjykatës së Lartë, e cila, më 28 janar 2016, pa praninë e palëve, miratoi një vendim ku e rrëzonte apelimin, pasi nuk përbante shkaqe ligjore për apelim. Ky vendim kishte përbante vetëm pjesën operative pa arsyetimin e plotë. Në periudhën përkatëse, njoftimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë realizohej me anë të një njoftimi në faqen e saj zyrtare të internetit dhe me depozitimini e vendimit të arsyetuar në regjistrin e Gjykatës së Lartë. Në dosjen e çështjes, ose në konstatimet e palëve, nuk ka asnjë tregues në lidhje me datën kur ishte lëshuar vendimi i Gjykatës së Lartë me arsyetimin e tij të plotë, apo nëse ishte publikuar në faqen e saj të internetit. Në konstatimet e saj të datës 21 prill 2019, kompania kërkuese pretendonte se vendimi nuk ishte publikuar ende.

7. Më 8 nëntor 2016, në Fletoren Zyrtare u publikua ligji nr. 99/206 i datës 6 nëntor 2016. Ky ligj shkurtonte afatin për depozitimini e një ankesë kushtetuese nga dy vite në katër muaj nga momenti i konstatimit të cenimit të një të drejte apo lirie kushtetuese. Gjithashtu, ligji parashikonte se afati i ri do të zbatohej nisur nga data 1 mars 2017.

8. Më 20 shtator 2017, kompania kërkuese i dërgoi një letër Gjykatës së Lartë ku kërkonte që t'i dorëzohej vendimi i marrë ndaj saj. Vendimi i arsyetuar iu dorëzua kompanisë kërkuese më 26 shtator 2017.

9. Kompania kërkuese depozitoi një ankesë kushtetuese më 4 tetor 2017. Më 8 nëntor 2017, Gjykata Kushtetuese e deklaroi këtë ankesë të papranueshme pasi ishte depozituar përtej afatit katërmujor, duke e nisur llogaritjen nga data në të cilën ishte miratuar vendimi i kontestuar i Gjykatës së Lartë. Ajo gjykonte se kompania kërkuese duhej të kishte bërë kërkësë për rezultatin e çështjes së saj në Gjykatën e Lartë në kohën e duhur.

#### LIGJI PËRKATËS VENDAS

10. Neni 19 i ligjit nr. 8588, i datës 15 mars 2000, në fuqi në kohën përkatëse, parashikonte se vendimet e Gjykatës së Lartë shpalleshin me arsyetimin e plotë jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e përfundimit të shqyrimit gjyqësor të një çështje të caktuar.

11. Sipas Nenit 482 të Ligjit të Procedurës Civile, në fuqi në periudhën përkatëse, lista e çështjeve që tregonte se cilat apelime do të shqyrtoheshin nga Gjykata e Lartë duhej të bëhej publike jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së shqyrimit. Palëve të një seance pranë Gjykatës së Lartë nuk i dërgohej njoftim personal.

#### LIGJI

##### I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

12. Kompania kërkuese u ankua për shkelje të së drejtës së saj për t'iu drejtuar gjykates referuar përllogaritjes së Gjykatës Kushtetuese të afatit për depozitimini e një ankesë kushtetuese. Kompania kërkuese u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës, pjesa përkatëse e të cilët parashikon si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga një gjykatë e pavarur ..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

### A. Pranueshmëria

13. Gjykata konstaton se kjo ankesë nuk është as e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë arsyе tjetër listuar në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsyе, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

### B. Meritat

#### 1. Argumentet e palëve

14. Kompania kërkuese argumentonte se ishte shkelur e drejta e saj për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sepse afati katërmujor për depozitimin e një ankesë kushtetuese ishte llogaritur nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur ky vendim i ishte dorëzuar kompanisë kërkuese.

15. Qeveria argumentoi se sipas praktikës së saj Gjykata Kushtetuese e llogariste afatin katërmujor për depozitimin e një ankesë kushtetuese nga data e miratimit të një vendimi të kontestuar. Qeveria ishte e mendimit se e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese mund t'i nënshtrohej rregullave që ishin më strikte sesa në rastin e gjykatave të zakonshme. Kompania kërkuese mund ta kishte mësuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nga faqja e internetit e asaj gjykate.

#### 2. Vlerësimi i Gjykatës

##### a) Parime të përgjithshme

16. Parimet përkatëse në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate dhe, veçanërisht, për t'iu drejtuar gjykatave të larta është përbledhur në çështjen *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018). Gjykata thekson veçanërisht se e drejta për t'iu drejtuar gjykatave mund t'i nënshتروhet kufizimeve, të cilat, sidooftë, nuk duhet të kufizojnë pjesën e së drejtës që i mbetet individit në një mënyrë të tillë, ose në një masë të tillë që dëmton vet thelbin e së drejtës. Gjithashtu, një kufizim nuk është në përputhje me nenin 6 § 1 nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe në këtë mënyrë nuk është një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (*ibid.*, § 78). E drejta për t'iu drejtuar një gjykatë cenohet kur rregullat nuk i shërbejnë më qëllimeve të sigurisë ligjore dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe krijojnë një lloj barriere e cila pengon gjykimin e çështjes së palës ndërgjyqëse sipas meritave nga gjykata kompetente (shih *Kart kundër Turqisë* [DHM], nr. 8917/05, § 79, GJEDNJ 2009, dhe *Arrožpide Sarasola dbe tē Tjerë kundër Spanjës*, nr. 65101/16 dhe 2 të tjerë, § 98, 23 Tetor 2018).

##### b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

17. Duke zbatuar parimet e mësipërme në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata thekson se e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kërkuesit individualë, si personat fizikë edhe ata juridikë, sigurohet me anë të mundësisë për të depozituar një ankesë kushtetuese. Një e drejtë e tillë, sidooftë, kufizohet, *inter alia*, nga afatet për depozitimin e një ankesë kushtetuese.

##### i) Qëllimi legjitim

18. Gjykata duhet të shqyrtojë fillimisht nëse kufizimi kishte pasur një qëllim legjitim. Nuk ka dyshim se caktimi i afateve për t'iu drejtuar gjykatave më të larta, në përgjithësi, është e lejueshme. Rregullat që përcaktojnë procedurën dhe afatet e zbatueshme për mjetet ligjore kanë si qëllim të garantojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe, veçanërisht, respektimin e parimit të sigurisë ligjore, dhe palët ndërgjyqëse duhet të jenë të përgatitura për zbatimin e rregullave ekzistues (shih *Miragall Escolano dbe tē tjerë kundër Spanjës*, nr. 38366/97 dhe 9 të tjerë, § 33, GJEDNJ 2000-I dhe *Lay Lay Company Limited kundër Maltës*, nr. 30633/11, § 56, 23 korrik 2013).

19. Më specifisht, për sa ka të bëjë me shkurtimin e afatit për depozitimin e një ankesë kushtetuese nga dy vite në katër muaj, Gjykata vëren se një ankesë kushtetuese në parim depozitohet ndaj vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjerë të formës së prerë. Megjithatë, një vendim i Gjykatës Kushtetuese mund t'i prishë këto vendime dhe ta kthejë procesin në fazën e mëparshme në një gjykatë apo në një gjykatë të shkallës së parë. Shkurtimi i afatit konkret, sipas këndvështrimit të Gjykatës, ka pasur për qëllim të fuqizojë sigurinë ligjore dhe të shërbejë për të shmangur periudhat e gjata përpëra se të arrihet një rezultat përfundimtar për një çështje të caktuar (shih *Cela kundër Shqipërisë*, nr. 73274/17, § 23, 29 nëntor 2022).

20. Për këtë arsy, Gjykata gjykon se shkurtimi i afatit për depozitimin e një ankesë kushtetuese ka ndjekur një qëllim legjitim.

*ii) Proporcionaliteti*

21. Mbetet për t'u gjykuar se sipas të gjitha rrëthanave përkatëse të çështjes, ka pasur një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis qëllimit dhe mjeteve të përdorura për ta arritur këtë qëllim.

22. Në lidhje me afatet për dorëzimin e apelimeve, nuk është detyra e Gjykatës që të marrë rolin e gjykatave vendase. Kryesisht i takon autoriteteve vendase, kryesisht gjykatave përkatëse, që të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendas. Roli i Gjykatës është i kufizuar në verifikimin nëse rezultatet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Konventën. Kjo shkon veçanërisht për interpretimin nga gjykatat e rregullave të një natyre procedurale si për shembull afatet për dorëzimin e apelimeve (shih *Jensen kundër Danimarkës*, nr. 8693/11, § 35, 13 dhjetor 2016).

23. Megjithatë mund të lind një problematikë në lidhje me parimin e sigurisë ligjore, jo vetëm si problem interpretimi i dispozitës ligjore në mënyrën e zakonshme, por edhe në formën e një pretendimi për ngritjen e paarsyeshme të një kërkese procedurale që pengon shqyrtimin e një padie për meritat, duke shkaktuar si pasojë shkeljen e së drejtës për mbrojtjen efektive të gjykatave. Për pasojë, teksa afatet në parim janë kufizime legitime të së drejtës për t'iu drejtar gjykatës, mënyra sipas së cilës ata zbatohen mund të shkaktojë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shembull nëse afati për depozitimin e një apeli fillon të llogaritet në një moment kur pala nuk e ka ditur dhe efektivisht nuk mund ta ketë ditur përbajtjen e vendimit të kontestuar të një gjykatë më të ulët (ibid., § 36).

24. Për sa i përket çështjes konkrete, Gjykata konstaton se kompania kërkuese nuk e kontestoi kërkësen për afatin katërmujor në çështjen e saj, por argumentoi se ky afat duhej të ishte llogaritur nga data kur u dorëzua vendimi i Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë çështje, dhe jo nga data kur u shpall vendimi, sipas gjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, problematika kryesore në këtë çështje është nëse afati për depozitimin e një ankesë kushtetuese do të duhej të ishte llogaritur nga data kur u miratua vendimi i Gjykatës së Lartë, apo në datën kur vendimi i arsyetuar iu dorëzua kërkuesit.

25. Sipas legjislacionit dhe praktikës përkatëse vendase, supozohej që njoftimi paraprak për seancat e zhvilluara nga Gjykata e Lartë duhej të publikoheshin në mjediset e saj dhe në faqen e saj të internetit. Palët nuk morën njoftim personal. Gjithashtu, në ligjin vendas nuk ka asnjë dispozitë që të parashikojë qartazi dorëzimin e vendimeve të arsyetuara të Gjykatës së Lartë për palët, dhe në praktikë nuk u ofrua një shërbim i tillë. Për më tepër, rezulton se në çështjen konkrete nuk u zhvillua asnjë seancë; Gjykata e Lartë mori një vendim për rrëzimin e menjëhershëm të apelimit të kompanisë kërkuese më 28 Janar 2016 me dyer të mbyllura. Në këtë mënyrë, kompania kërkuese nuk kishte dijeni për këtë gjë. Vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë iu dorëzua kompanisë kërkuese më 26 shtator 2017, pas kërkësës së saj me shkrim, dhe ky është momenti kur kompania kërkuese pati mundësinë e parë të njihet me ekzistencën, dhe arsyetimin, e vendimit të Gjykatës së Lartë.

26. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se palët duhet të shfrytëzojnë të drejtën për të depozituar një apelim nga momenti kur bëhen me dije për vendimet gjyqësore që vendosin një barrë ndaj tyre, apo që mund të cenojnë të drejtat ose interesat e tyre legitime. Në të kundërt, gjykatat mund ta shkurtojnë ndjeshëm afatin për dorëzimin e një apeli ose ta bëjnë apelimin të pamundur duke vonuar dorëzimin e vendimeve të tyre. Si mënyrë komunikimi midis organit gjyqësor dhje palëve, dorëzimi i vendimit i bën palët me dije për këtë vendim dhe arsyet e tij, duke iu dhënë mundësinë të apelojnë ndaj tij nëse e gjykojnë me vend (shih, *Miragall Escolano dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 37). Në lidhje me Shqipërinë, Gjykata tashmë ka vendosur, edhe pse në një kontekst tjetër të vendimeve *in absentia*, se afati për depozitim e një ankesë kushtetuese do të duhej të llogaritej nga data kur kërkuesi bëhej me dije për vendimin që do të kontestohej (shih *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 31 dhe 53, 10 Maj 2011).

27. Gjykata është e mendimit se në mënyrë që kompania kërkuese të kishte mundësi të depozitonte një ankesë kushtetuese të mirëargumentuar, ajo do të duhej të ishte bërë me dije në lidhje me përmbytjen dhe arsyetimin e plotë të Gjykatës së Lartë, edhe pse ishte rasti i një arsyetimi të përshtpjtar. Duke qenë se kompania kërkuese nuk pati mundësinë të njihej, deri më 26 Shtator 2017, me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, apo edhe me faktin e thjeshtë se apelimi ishte kundërshtuar, nuk mund të thuhet se ka pasur të drejtën efektive për një ankesë kushtetuese më herët se ajo datë (krahaso *Georgiv Nikolayevich kundër Rusisë*, nr. 4543/04, § 54, 1 prill 2010).

28. Nëse pranohet pozicioni i Gjykatës Kushtetuese, do të krijohej një situatë në të cilën kompania kërkuese nuk do të kishte mundësi të studionte tekstin e vendimit të Gjykatës së Lartë përpëra se të depozitonte ankesën e saj kushtetuese. Një situatë e tillë vështirë se mund të pajtohet me Nenin 6 të Konventës, i cili, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, materializohet si një parim që lidhet me administrimin e duhur të drejtësisë në lidhje me kërkuesin se vendimet gjyqësore duhet të shprehin qartazi arsyet tek të cilat mbështeten (shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999-I; *Angel Angelov kundër Bullgarisë*, nr. 51343/99, § 38, 15 shkurt 2007; dhe *Georgiv Nikolayevich Mikhaylov*, cituar më sipër, § 55).

29. Në lidhje me argumentin e Qeverisë se kompania kërkuese mund të ishte vënë në dijeni përvendimin e Gjykatës së Lartë me anë të faqes së internetit të gjykatës, Gjykata konstaton se, së pari, Qeveria nuk ka paraqitur prova se ky vendim konkret është bërë publik në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, duhet të përmendet se apelimi kishte qenë pezull pranë Gjykatës së Lartë për disa vite përpëra se të rrëzohej me dyer të mbyllura dhe pa ndonjë njoftim paraprak përpalët. Më i rëndësishëm – dhe si parim – është fakti se praktika e zakonshme e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë në atë periudhë ishte të publikohej pjesa operative e vendimit të saj pas miratimit, kur edhe do të duhej të kalonte një periudhë e konsiderueshme përpëra se të publikohej vendimi me arsyetimin. Kështu, mund të ndodhë që e gjithë periudha për depozitim e një ankesë kushtetuese mund të përfundonte përpëra se të publikohej dhe të vihej në dispozicion të palëve arsyetimi i plotë i vendimit të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata konstaton se përpëra datës 1 mars 2017, afati përvenditim e një ankesë kushtetuese kishte qenë dy vjet. Duke pasur në konsideratë kohëzgjatjen e afatit, mund të mos ketë qenë plotësisht e paarsyeshme të pritej që kërkuesit të bëheshin me dije përvendimet e Gjykatës së Lartë nga faqja e saj e internetit, në mungesë të dorëzimit personal të vendimit, pasi ata kishin mjaft kohë për ta realizuar një gjë të tillë. Megjithatë, një afati i ri katërmujor rezulton shumë i shkurtër që kërkuesit të kishin mjaftueshëm kohë përvendimi mësuar përvenditim e Gjykatës së Lartë me anë të faqes së internetit të gjykatës, veçanërisht duke pasur në konsideratë përudhën nga momenti i miratimit të pjesës operative deri në arsyetimin e plotë të vendimeve të saj.

30. Për sa më sipër, Gjykata është e mendimit se afati katërmujor përvenditim e një ankesë kushtetuese, në rrëthanat konkrete, duhet të ishte llogaritur prej datës 26 shtator 2017, kur vendimi i

Gjykatës së Lartë iu dorëzua kompanisë kërkuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e llogariti atë afat nga data 28 janar 2016, datë në të cilën Gjykata e Lartë miratoi vendimin e saj dhe e deklaroi ankesën kushtetuese të kompanisë kërkuese të papranueshme, pasi ishte depozituar jashtë afatit. Për rrjedhojë, kompania kërkuese ishte privuar nga e drejta e saj për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

31. Në këtë mënyrë,është shkelur neni 6 § 1 i Konventës për sa i përket të drejtës së kompanisë për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

## II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

### 32. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërbirim të drejtë palës së dëmtuar.”

#### A. Dëmshpërbimi

33. Kompania kërkuese kërkoi 2,050,843 euro për dëmin pasuror dhe 200,000 euro për dëmin jopasuror.

34. Qeveria i vlerësoi këto shuma si të pambështetura në fakte dhe të tepërtë.

35. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje shkakore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar; për këtë arsy, ajo e kundërshton këtë pretendim. Megjithatë, ajo i akordon kërkuesit 3,600 euro për dëmin jopasuror plus çdo taksë që mund të tarifohet.

#### B. Kostot dhe shpenzimet

36. Kërkuesi kërkoi edhe 64,500 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendase dhe përparrë Gjykatës.

37. Qeveria i vlerësoi ato shuma si të pambështetura në fakte dhe të tepërtë.

38. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shërbimet kur provohet se ato janë shpenzuar, kanë qenë të nevojshme për t’u bërë, dhe janë të arsyeshme për sa i përket kuantit. Në çështjen konkrete, duke pasur në konsideratë dokumentet në zotërim të saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e rrëzon pretendimin për kostot dhe shpenzimet gjatë procesit vendas dhe e gjykon të arsyeshme që të akordojë shumën prej 2,000 eurosh për procesin përparrë Gjykatës, plus çdo taksë që mund t’i tarifohet kompanisë kërkuese.

#### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. E deklaron kërkësën të pranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

3. Gjykon

a) se Shteti përgjegjës duhet t’i paguajë kompanisë kërkuese brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet i formës së prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i) 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, në lidhje me dëmin jopasuror;

ii) 2,000 euro (dy mijë euro), plus çdo taksë që mund t’i tarifohet kompanisë kërkuese, për kostot dhe shpenzimet;

b) se që prej përfundimit të periudhës tremujore të sipërpërmendor deri në shlyerje, për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhëniec të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje.

4. Rrëzon pjesën tjeter të pretendimit të kompanisë kërkuese për justifikimin të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 9 maj 2023, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Milan Blaško**  
SEKRETAR

**Pere Pastor Vilanova**  
KRYETAR